

RREGULLORJA E EKSPOZITËS NDËRKOMBËTARE TË ARTEVE PAMORE “ONUFRI”

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Ekspozita Ndërkombëtare e Arteve Pamore mban emrin e ikonografit të mesjetës Onufri.
2. Ekspozita Ndërkombëtare e Arteve Pamore “Onufri” është një ekspozitë vjetore që organizohet dhe realizohet nga Galeria Kombëtare e Arteve (GKA), nën kujdesin dhe mbështetjen nga Ministria e Kulturës dhe nga kontributi i sponsorizuesve të ndryshëm si: fondacione, shoqata, subjekte juridike dhe fizike që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Shpallja e fillimit të procedurave për pranimin e propozimit kuratorial më të mirë për zhvillimin e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri” bëhet brenda muajit Prill të çdo viti, nëpërmjet një konference për shtyp dhe njoftimeve në media edhe elektronike.
4. Shpallja e kuratorit/kuratores dhe platformës fituese bëhet jo më vonë se fundi i muajit Maj, të çdo viti.
5. Ekspozita Ndërkombëtare e Arteve Pamore “Onufri” zhvillohet në fund të çdo viti brenda muajve Nëntor – Dhjetor, në harmoni me kalendarin vjetor të GKA.

KAPITULLI II

PARIMET DHE FUNKSIONET

Neni 2

Ekspozita Ndërkombëtare e Arteve Pamore “Onufri”, e zhvillon veprimtarinë në përputhje me Ligjin Nr. 10352, date 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, VKM nr. 595 datë 29.12.1993 “Për kriteret e shpalljes së konkurseve me karakter kombëtar dhe lokal”, i ndryshuar, bazuar në Statutin e GKA-se miratuar me Urdhër 114, datë 20.03.2006 “Për miratimin e statutit të Galerisë Kombëtare të Arteve”, i ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 3

1. Ekspozita Ndërkombëtare e Arteve Pamore “Onufri” ka si synim të nxisë krijimtarinë dhe rrisi vlerat krijuese, evidentojë, zhvillojë dhe ekspozojë artistët e përzgjedhur në artet pamore.
2. Ekspozita Ndërkombëtare e Arteve Pamore “Onufri” në konceptin e saj ndalohet të ketë prirje dhe diskriminime me bazë raciste, nacionaliste, politike, fetare dhe pornografike.
3. Ekspozita Ndërkombëtare e Arteve Pamore “Onufri” paraqet veprat dhe artin e artistëve shqiptarë dhe të huaj sipas platformës dhe konceptit të kuratorit/ kuratores, pas përzgjedhjes së tij/saj nga Këshilli Organizativ.
4. Ekspozita Ndërkombëtare e Arteve Pamore “Onufri” zhvillohet zakonisht në GKA, Tiranë. Ekspozita mund të hapet, paralelisht ose ekskluzivisht, edhe në mjedise të tjera kulturore, nëse e kërkon koncepti kuratorial.

KAPITULLI III

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 4

1. Struktura e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri” është si më poshtë:
 - a) Këshilli Organizativ
 - b) Kuratori
 - c) As/Kuratori
 - d) Koordinatori
 - e) Juria

Neni 5

Këshilli Organizativ

1. Këshilli Organizativ përbëhet nga minimumi 5 vetë:
 - a) 2 (dy) nënpunës të GKA-së.
 - b) 3 (tre) specialistë të fushës që nuk janë punonjës ose anëtarë të Bordit të GKA-së.
2. Këshilli propozohet dhe miratohet me vendimin e Bordit të GKA-së .

Neni 6

Kompetencat e Këshillit Organizativ

1. Këshilli Organizativ, i propozuar dhe miratuar me vendimin e Bordit të GKA-së, pas mbledhjes së tij të parë propozon dhe miraton me votim të hapur nga anëtarët e tij kryetarin/kryetaren e Këshillit Organizativ.

2. Këshilli organizativ ka këto kompetenca:

- a) Zgjedh kuratorin e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri” në bazë të platformës së propozuar, duke reflektuar mbi çështjet dhe problematikat kombëtare dhe ndërkombëtare mbi artin, estetikën, shoqërinë, etj. dhe eksperiencës profesionale të kuratorit.
- b) Bashkëpunon me kuratorin, as/kuratorin dhe koordinatorin për realizimin e të gjitha proceseve për kryerjen e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri”, nëse kjo është e nevojshme.
- c) Mbikqyr dhe jep këshilla mbi veprimtarinë financiare të Ekspozitës.
- d) 30 ditë pas mbylljes së Ekspozitës, kryetari/kryetarja i/e Këshillit Organizativ, Kuratori/As.Kuratori, Koordinatorin dhe Drejtorin e Galerisë Kombëtare të Arteve percjellin mbylljen e situacionin përfundimtar financiar të të gjitha shpenzimeve të ekspozitës, dhe vlerësimin e tyre për këtë aktivitet në Ministrinë e Kulturës.

3. Pas zgjedhjes së kuratorit/kuratores me idenë më të mirë dhe platformës fituese Këshilli Organizativ dhe Galeria Kombëtare e Arteve vënë në dijeni për këtë Ministrinë e Kulturës.

Neni 7 **Kuratori**

1. Kuratori/kuratorja mund të jetë me kombësi/nënshtetësi shqiptare apo të huaj.
2. Shpallja e Kuratorit për publikun dhe artistët bëhet në Maj të çdo viti, pas një konkursi dhe thirrje të hapur në media dhe mediat elektronike e cila zgjat të paktën 2 javë, si dhe pas perzgjedhjes e miratimit të kuratorit nga Këshilli Organizativ.
3. Kuratori hyn në marrdhënie kontraktuale të përkohshme pune me GKA-në, sipas dispozitave në fuqi të Kodit Civil dhe Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë përgjegjësitë sipas kësaj rregulloreje.
4. Kuratori nuk duhet të jetë punonjës i GKA-së dhe nuk mund të jetë anëtar i jurisë së Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri”.
5. Kuratorit dhe as/kuratorit, ju vihen në dispozicion ambiente të GKA dhe materiale pune, për zhvillimin e punës për Ekspozitën Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri”.
6. Kompetencat e kuratorit janë si mëposhtë:
 - a) Ka përgjegjësi të plotë për organizimin dhe zhvillimin e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri” gjatë fazës përgatitore, zhvillimit dhe mbylljes së saj.
 - b) Bashkërendon dhe koordinon me Galerinë Kombëtare të Arteve planin e punës për realizimin me sukses të ekspozitës.
 - c) Është përgjegjës për perzgjedhjen finale të veprave të cilat do të paraqiten në Ekspozitën Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri”.

- d) Bashkëpunon me as/kuratorin për realizimin e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri” duke i dhënë atij/asaj detyra të qarta.
- e) Bën propozimin për banerin, ftesën, katalogun e elementët e tjerë grafikë të ekspozitës.
- f) Në bashkëpunim dhe koordinim me Galerinë Kombëtare të Arteve krijon dhe mban kontakte me mediat kombëtare dhe ndërkombëtare mbi ekspozitën “Onufri” dhe publikon të paktën 2 artikuj mbi ekspozitën “Onufri”.
- g) Ndjek ardhjen, depozitimim dhe mirëmbajtjen e veprave që do të paraqiten në konkurim.
- h) Për veprat e para- përzgjedhura për ekspozitën kuratori fillimisht konsultohet me sektorin e konservim – restaurimit në GKA për ekspozueshmërinë e tyre dhe kondicionin fizik.
- i) Në bashkëpunim me as/kuratorin, koordinatorin dhe Drejtorin e Galerisë Kombëtare të Arteve mund të hyjë në kontakt me fondacione, shoqata, subjekte juridikë dhe fizikë, për të mundësuar sponsorizimin e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri”. Miratimi përfundimtar i sponsorit/sponsorave, termave të sponsorizimit dhe zërave që mund të sponsorizohen mbeten e drejtë ekskluzive dhe ligjore e Galerisë Kombëtare të Arteve.
- j) Kuratori në bashkëpunim me Galerinë Kombëtare të Arteve organizojnë takim të hapur me publikun, artistët pjesmarrës dhe jo pjesmarrës për të shkëmbyer mendimet, jo më larg se një javë para vendimit të Jurisë për veprën fituese.
- k) Pas mbylljes së ekspozitës Kuratori bën një relacion me shkrim mbi procedurat e ndjekura për organizimin, realizimin dhe ngritjen e ekspozitës, si dhe impaktin e saj.

Neni 8 **As/kuratori**

1. As/kuratori zgjidhet nga kuratori.
2. As/kuratori mund të jetë me kombësi/nënshtetësi shqiptare apo të huaj.
3. As/kuratori është ndihmës dhe bashkëpunëtor i kuratorit. Detyrat e tij caktohen nga kuratori.
4. Kuratori hyn në marrdhënie kontraktuale të përkohshme pune me GKA-në, sipas dispozitave në fuqi të Kodit Civil dhe Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.
5. Në përfundim të Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri” brenda një periudhe 1 (një) mujore as/kuratori koordinon dorëzimin e punëve pjesëmarrëse në ekspozitë nga artistët e huaj dhe artistët shqiptarë (dhe kthimin e tyre në origjinë nëse është përdorur posta). Detajet në lidhje me transportin dhe sigurimin e veprave të artistëve bëhet ndërmjet një marrëveshje të GKA-së me artistët.
- 6.

Neni 9

Koordinatori

1. Koordinatori zgjidhet nga Bordi i GKA-së, por nuk duhet të jetë anëtar jurie. Ai duhet të jetë punonjës i GKA-së.
2. Detyrat e tij përcaktohen në bazë të një plani pune të hartuar nga kuratori dhe të miratuar nga Bordi i GKA-së.
3. Koordinatori ndihmon të hartojë dhe mban gjithë dokumentacionin për shpenzimet financiare të aktivitetit.
4. Koordinatori zhvillon takime administrativo-organizative me artistët sipas udhëzimeve të kuratorit.
5. Koordinatori raporton tek Këshilli Organizativ për ecurinë financiare të aktivitetit.
6. Koordinatori ndihmon në përgatitjen e informacionit për faqen e internetit, e cila administrohet nga Galeria Kombëtare e Arteve.
7. Koordinatori përfshin aktivitetin “Onufri” në axhenda ndërkombëtare, për të promovuar këtë aktivitet.

Neni 10

Artistët dhe seleksionimi i veprave të artit

1. Në ekspozitën “Onufri” ftohen të marrin pjesë, dhe marrin pjesë, artistë shqiptarë dhe/ose të huaj sipas kriterëve të shpallura.
2. Artistët pjesëmarrës përzgjidhen vetëm nga kuratori i ekspozitës.
3. Artisti/artistja e përzgjedhur mbush dhe nënshkruan një Aplikim për Pjesëmarrje, që është publik edhe në media elektronike për të paktën 3 javë, që në muajin Qershor të çdo viti, ku përcaktohen qartë kushtet dhe termat e pjesëmarrjes në edicionin e ekspozitës “Onufri”. Ky dokument rregullon edhe marrdhëniet mes kuratorit, artistit, ekspozitës dhe GKA-së.
4. Vepra që do të paraqitet në ekspozitë nuk duhet të jenë ekspozuar më parë.
5. Veprat e përzgjedhura duhet të respektojnë të drejtat e autorit.
6. Artisti/artistja mund të zgjedhë që vepra e tij/saj të mos jetë pjesë e vlerësimit të jurisë për çmim.
7. Elementë teknikë-logjistikë si p.sh. shpenzimet e transportit të veprës, të udhëtimit, apo akomodimit të artistit hartohen sipas kriterëve të shpallura për secilin edicion të ekspozitës “Onufri”, nisur edhe nga platforma kuratoriale.
8. Në lidhje me transportin para dhe pas përfundimit të ekspozitës, GKA rregullon përgjegjësitë nëpërmjet një marrëveshjeje me artistët.

Neni 11

Juria e ekspozitës

1. Juria e ekspozitës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, profesionistë në fushën e arteve pamore.
2. Anëtarët e jurisë mund të jenë me kombësi/nënshitetësi shqiptare apo të huaj.
3. Anëtarët e jurisë propozohen nga Bordi i GKA-së dhe miratohen nga Ministri/a i/e Kulturës.
4. Kryetari i Jurisë zgjidhet me votim të hapur nga anëtarët e Jurisë.
5. Kompetencat e Jurisë:
 - a) Juria analizon dhe vlerëson me shkrim çdo vepër të ekspozuar në ekspozitë, përveç atyre të deklaruara pjesëmarrëse por jashtë konkurimit, dhe merr një vendim.
 - b) Juria dokumenton vendimin e saj final me shkrim dhe e depoziton në GKA.
6. Mbledhjet e jurisë nuk janë të hapura për publikun.
7. Anëtarët e Jurisë shpërblehen për punën e tyre sipas kuadrit ligjor në fuqi.
8. Çertifikata e veprës fituese të Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “Onufri”, nënshkruhet nga kryetari i Jurisë, Kuratori dhe Drejtori i GKA-së.

KAPITULLI IV

ORGANIZIMI FINANCIAR

Neni 12

1. Ekspozita Ndërkombëtare e Arteve Pamore “Onufri” mbështetet financiarisht edhe nga Ministria e Kulturës në bazë të propozimit, çdo vit, nga Galeria Kombëtare të Arteve, si dhe nga kontributi i sponsorizuesve të ndryshëm si: fondacione, shoqata, subjekte juridike dhe fizike që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

2. Çmimi i ekspozitës është vetëm 1 (një) në vleftën 300.000 lekë. Juria shpall vetëm një fitues.
3. Çmimi përcaktohet dhe jepet nga Juria brenda muajit Dhjetor, të cdo viti.
4. Çmimi që fitohet për një vepër mund të jetë realizuar prej një, dy apo më shumë artistësh si bashkëautorë. Ai trajtohet si një çmim individual.
5. Vlera e çmimit parashikohet në buxhet-preventivin e Ekspozitës Ndërkombëtare për Artet Pamore “Onufri”.

6. Fituesi/t i/e çmimit paguan/jnë të gjitha detyrimet taksore në fuqi në Republikën e Shqipërisë në momentin e fitimit të çmimit. Detyrimet taksore zbriten nga shuma e përgjithshme e çmimit të fituar.
6. Galeria Kombëtare e Arteve mund të ofrojë çmime të tjera për artistët pjesëmarrës, sipas marrveshjeve me sponsorizues dhe donator, si edhe për shembull mundësinë e ekspozimit të veprave jashtë shtetit, programe rezidence, çmim audience, etj.

KAPITULLI V

NDRYSHIME NË RREGULLOREN E EKSPOZITËS NDËRKOMBËTARE TË ARTEVE PAMORE "ONUFRI"

Neni 14

Ndryshimet në rregulloren e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore "Onufri", miratohen nga Ministri i Kulturës.

Tiranë, më 15/03/2015